



Lulzim Ismajli

Zëvendësguvernator për Operacione Bankare

Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2016 ka riemëruar z. Lulzim Ismajli në pozitën zëvendësguvernatorit për Operacione Bankare për një mandat pesë vjeçar duke filluar nga data 1 shtator 2016.

Në cilësinë e zëvendësguvernatorit për Operacione Bankare z. Ismajli ka nën mbikëqyrje pesë departamente dhe dy divizione të mëvetësishme: Departamentin e Menaxhimit të Mjeteve dhe Letrave me Vlerë, Departamentin e Sistemit të Pagesave, Departamentin e Statistikës, Departamentin e Parave dhe Marrëdhënieve Bankare, Departamentin e Teknologjisë Informative, Divizionin e Regjistrimit të Kredive dhe Divizionin e Rishqyrtimit të Ankesave.

Zoti Ismajli që nga viti 2011 është anëtar i Bordit Ekzekutiv, funksionet kryesore të anëtarit të Bordit Ekzekutiv në Bankën Qendrore të Kosovës janë zhvillimi i qëllimeve dhe objektivave strategjike për Bankën Qendrore të Kosovës, që ndërlidhen si me hartimin e planit rregullativ dhe operacional.

Përgjegjësitë e tjera në cilësinë e anëtarit të Bordit Ekzekutiv janë: sigurimi i një sistemi financiar të qëndrueshëm; të rregullojë, licencojë dhe mbikëqyrë institucionet financiare; të mirëmbajë sistem të pagesave të sigurt dhe efikas; të kontribuojë në stabilitetin e çmimeve; të menaxhojë rezervat ndërkombëtare të vendit; të veprojnë si bankier, agjent fiskal dhe këshilltar financiar për Qeverinë dhe entitetet e tjera publike; të kryejë analiza ekonomike dhe prodhojë statistika monetare-financiare dhe të bilancit të pagesave.

Pozita të tjera udhëheqëse që i ka ushtruar z. Lulzim Ismajli janë:

Nga viti 2011-2016 ka qenë Zëvendësguvernator për Operacione Bankare në Bankën Qendrore të Kosovës.

Nga viti 2005 – 2011 ka qenë Drejtor i Thesarit në Ministrinë e Financave;

Aktivitetet dhe përgjegjësitë kryesore kane qenë: Menaxhimi i Ekzekutimit të Buxhetit, Menaxhimi i llogarive bankare të Qeverisë, Menaxhimi i alokimeve, Raportimi financiar, Menaxhimi i granteve të donatorëve, Menaxhimi i parasë së gatshme dhe Menaxhimi i borxheve, Përgatitja e rregullave për të hyrat, Shpenzimet e parave publike, Raportimin

financiar, Menaxhimin financiar dhe kontrollin, Zhvillimi i planit strategjik dhe planit vjetor për Departamentin e Thesarit.

Gjate vitit 2002-2004 z. Ismajli ka mbajtur pozitën e Specialist për Menaxhimin e Financave në Projektin e Bankës Botërore, Prishtinë- "Zhvillimi i Sektorit Privat" në kuadër të Autoritetit Qendror Fiskal.

Aktivitetet kryesore kane qenë: Menaxhimi i projekteve, ri mbursimi, disbursimi i fondeve nga Banka Botërore, menaxhimi i llogarive bankare, barazimi, raportimi financiar dhe ai i menaxhimit.

Në periudhën 2001-2002 ka qenë i emëruar në pozitën: Ndhmësdrejtor për Menaxhimin e Granteve në Departamentin e Thesarit në kuadër të Autoritetit Qendror Fiskal, Prishtinë, Kosovë.

Detyrat dhe përgjegjësitë kane qenë: Menaxhimi i ekzekutimit të buxhetit të projekteve të financuara nga donatorët.

Nga viti 2000-2001 ka punuar në pozitën Analist i të Hyrave Publike, në Departamentin e Thesarit në kuadër të Autoritetit Qendror Fiskal në Prishtinë.

Nga viti 1999-2000 ka punuar mësimmhënës në shkollën e mesme ekonomike "Hivzi Sulejmani" Fushë Kosovë.

Aktivitete të tjera të kryera nga zoti Ismajli krahas punës bazë janë:

- a) Nga viti 2004-2011, Kryesues i komitetit drejtues të projektit për mbështetje të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (projekti i financuar nga Komisioni Evropian); Prishtinë,
- b) Nga viti 2006-2011 Anëtar i Bordit, Autoriteti Qendror Bankar i Pagesave; Prishtinë,
- c) Nga viti 2009-2011, Kryesues i komitetit drejtues ndërkombëtar të kompanisë Free Balance me seli në Kanada;

Në vitin 1995 z. Ismajli ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Prishtinës, në drejtimin Ekonomia e Ndërmarrjes. Gjithashtu edhe studimet pasuniversitare (Master i Shkencave Ekonomike) i ka kryer në Universitetin e Prishtinës në vitin 2011 në degën banka dhe financa.

Përveç përvojës së lartcekur, z. Lulzim Ismajli ka ndjekur një mori trajnimesh dhe specializimesh në fushën e bankave, financave dhe menaxhmentit si dhe ka qenë pjesëmarrës në shumë konferenca ndërkombëtare në fushën e bankave, financave publike, etj.

Z. Lulzim Ismajli është i lindur me 26 Qershor 1970 në Miradi të Poshtme, Komuna e Fushë Kosovës, është i martuar dhe ka dy fëmijë.